



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

NR. 243, datë 29.10.2019

PËR

REFUZIMIN E KËRKESËS SË Z.{...}, PËR KTHIMIN NË FUNKSIONIN E
GJYQTARIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61, pika 2, shkronja “a”, 86 dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 57, 64 dhe 167, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi dëgjoi relatorin z.Alban Toro, si edhe shqyrtoi dokumentacionin e administruar,

VËREN

I. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Me Vendimin nr.8, datë 30.08.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. {...} është emëruar ndihmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Më pas, me Dekretin nr.2526, datë 14.02.2000, të Presidentit të Republikës, z. {...} është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
3. Me Vendimin nr.230, datë 28.05.2008, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është vendosur ndër të tjera se: “...*Omissis...Pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, në lidhje me shërbimin pranë strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër, z. {...}, si edhe ruajtjes për këtë gjyqtar, të statusit të gjyqtarit, duke marrë parasysh edhe pëlqimin e dhënë nga z. {...}, në përfundim vendosi ta pranojë këtë kërkesë...*”.
4. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për Shkarkim dhe Emërim në detyrë”, nr. 627, datë 21.05.2008, Z. {...} është emëruar në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

5. Gjatë vijimit të ushtrimit të këtij funksioni, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.54, datë 21.01.2009, “Për Shkarkim dhe Emërim në detyrë”, ndër të tjera është vendosur : “1. Z. {...} Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shkarkohet nga kjo detyrë... omissis...”.

6. Me shkresën nr.2564/1, datë 16.05.2019, të Departamentit të Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit pranë Këshillit të Ministrave, Këshillit të Lartë Gjyqësor i është dërguar relacioni që shoqëron vendimmarrjen e mësipërme, ku evidentohen shkeljet e konstatuara dhe që kanë përbërë shkak për shkarkimin e z. {...} nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

7. Konkretisht, në këtë relacion pasqyrohet se: “...Omissis... Këto shkelje në mënyrë të përmbledhur janë: Zvarritje e procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës nëpërmjet shkeljes së afateve ligjore për shqyrtimin e ankimeve administrative të paraqitur nga subjektet e shpronësuar (gjithsej 155 raste); Organizim i dobët i punës brenda strukturës administrative të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nëpërmjet mungesës së mbikëqyrjes së zbatimit të afateve ligjore, marrjes së masave disiplinore për shkelësit e këtyre afateve ligjore, mosrespektimit të Kodit të Punës lidhur me shpërblimin e punonjësve për orët jashtë orarit, lëvizjes së shpesh të pajustificuar të personelit dhe mungesës së mbikëqyrjes së zbatimit të detyrimeve ligjore nga zyra e Arkiv Protokollit për komunikimet/njoftimet si brenda Agjencisë dhe Zyrat Rajonale, ashtu edhe me të tretë...”.

8. Krahas kësaj procedure disiplinore, rezulton se më herët, në bazë të informacionit “Për referimin e veprës penale” datë 22.09.2008, të oficerit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo e fundit, më datë 29.09.2008, ka regjistruar procedimin penal nr.4908, viti 2008, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal. Në kuadër të këtij procedimi penal, më datë 08.10.2008, z. {...} është marrë i pandehur për akuzën e “Shpërdorimit të detyrës kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 248-25 të Kodit Penal. Fakti penal sipas akuzës lidhej pas marrjes së Vendimit nr.2535 datë 14.08.2008 nga Z.R.K.K.P^{ja} Tiranë me të cilin është vendosur njohja e se drejtës se pronësisë të subjektit të shpronësuar për sipërfaqen prej 48.000m² të ndodhur në fshatin Barthore, Peqinaj-Komuna Synej Kavajë, kthimin e sipërfaqes së lirë të truallit prej 472.800 m² dhe kompensimin për sipërfaqen e zënë prej 7200m², akti cili i është dërguar për shqyrtim Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP i pandehuri {...} me urdhrin nr.3314/1 prot., datë 15.09.2008 ka vendosur mos ushtrimin të iniciativës duke bërë që Vendimi nr.235 datë 14.08.2008 i ZRKKP për njohjen e dhe kthimin e kompensimin e ish pronareve “Shijaku” të marrë formë të prerë. Si i pandehur z. {...} me këtë veprim ka kryer veprën penale “Shpërdorimit të detyrës kryer në bashkëpunim” duke bashkëpunuar me të pandehurin {...}, i pandehuri z. {...} ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin dhe përmbushjen e rregullt të detyrës së tij sepse tërësia e provave dhe fakteve tregojnë se ai ka pasur dijeni të plote për pavërtetësinë e dokumenteve të dosjes “Shijaku” si dhe faktin që se si është treguar tejet aktiv për përfundimin e saj sa më parë në favor të kërkuesve dhe interesuarve.

9. Në përfundim të hetimeve paraprake, më datë 24.04.2009, çështja penale kundër z. {...} është dërguar për gjykim përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

10. Me Vendimin nr.718, datë 07.05.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë është vendosur “*Deklarimi i pafajshëm i të pandehurit {...}*”.

11. Me Vendimin nr.1280, datë 13.02.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur: “*Lënien në fuqi të Vendimit nr.718, datë 07.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë*”.

12. Me shkresën e datës 18.02.2013, z. {...}i është drejtuar ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku pasi informon ndër të tjera se: “*...Omissis.. menjëherë pas lirimit nga detyra gjatë kohës që kryeja lejen e zakonshme më është komunikuar akuza duke më vendosur në pamundësi ligjore për t’u kthyer në funksionin e gjyqtarit*” dhe në përfundim i ka kërkuar kthimin në funksionin e gjyqtarit.

13. Nuk rezulton që ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë të ketë marrë në shqyrtim dhe të jetë shprehur në lidhje me kërkesën e z{...}për kthimin në detyrën e gjyqtarit.

14. Më datë 17.03.2015, z. {...}ka iniciuar një proces gjyqësor kundër ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke kërkuar: “*Detyrimin e palës së paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë të marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur për të rikthyer në detyrën e gjyqtarit, në respekt të statusit të paditësit si edhe detyrimin për të paguar pagën e gjyqtarit nga data 21.02.2009 deri në fillimin e detyrës*”.

15. Me Vendimin nr.2839, datë 25.05.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendosur: “*Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë. / Detyrimin e palës së paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të marrë në shqyrtim kërkesën e palës paditëse z. {...}, depozituar më datë 18.02.2013...*”.

16. Me Vendimin nr. 121, datë 28.01.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit është vendosur: “*Lënien në fuqi të Vendimit nr.2839, datë 25.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*”.

17. Me Vendimin nr.1057, datë 16.10.2018, të Gjykatës së Lartë është vendosur: “*Mospranimin e rekursit të palës së paditur, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kundër Vendimit nr.121, datë 28.01.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit*”.

18. Pas vendimit të dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit, më datë 29.02.2016, z. {...} ka investuar përmbaruesin gjyqësor/Shoqërinë Përmbarimore “ALBIUS”, duke kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë si më lart, ndërsa nga përmbaruesi gjyqësor, përmes njoftimeve dhe kërkesave të datës 29.02.2016, fillimisht ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe, më pas, Këshillit të Lartë Gjyqësor, u ka kërkuar ekzekutimin e Vendimit nr.2839, datë 25.05.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

II. LIGJI I ZBATUESHËM

19. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 147 në pikat 4, 5 dhe 6, sipas rregullimit në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes, ku parashikohej se:

“...4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit.

5. Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor.

6. Gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Kundër këtij vendimi gjyqtari ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë, e cila në këtë rast, vendos me kolegje të bashkuara”.

20. Ligji nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësorë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 20 (“Palëvizshmëria e gjyqtarit”), ku parashikohej se:

“Gjyqtari nuk mund të lëvizë nga detyra, përveç rasteve kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën 65 vjeç, të daljes në pension;
- c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- ç) shkarkohet nga detyra”.

Neni 21 (“Transferimi dhe delegimi i gjyqtarëve”), ku parashikohej se:

“Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor”.

Neni 28 (“Ruajtja e statusit të gjyqtarëve që shërbejnë në institucione të tjera”), ku parashikohej se:

“1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës.

2. Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave.

3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale.

4. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

21. KARTA EVROPIANE MBI STATUSIN E GJYQTAREVE

“1.3. Lidhur me çdo vendim që ndikon në përzgjedhjen, rekrutimin, emërimin, përparimin në karrierë ose pushimin e funksioneve të një gjyqtari/e, statuti parashikon ndërhyrjen e një

autoriteti të pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, brenda të cilit të paktën gjysma e atyre që marrin pjesë të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre, duke ndjekur metoda që garantojnë përfaqësimin më të gjerë të gjyqësorit.

EMËRIMI DHE PALËVIZSHMËRIA

3.1. Vendimi për të emëruar një kandidat/e të përzgjedhur si gjyqtar/e, dhe për ta caktuar atë në një gjykatë, merret nga autoriteti i pavarur i përmendur në paragrafin 1.3 këtu më lart ose me propozimin e tij, ose rekomandimin e tij ose me miratimin e tij ose pas mendimit të tij.

3.2. Statuti përcakton rrethanat në të cilat veprimtaritë e mëparshme të kandidatit/es, ose ato në të cilat janë angazhuar të afërmit e tij/saj, mundet, për arsye të dyshimeve objektive dhe legjitime që ato ngrenë përse i përket paanësisë dhe pavarësisë së kandidatit/es në fjalë, të përbëjnë një pengesë për caktimin e tij/saj në një gjykatë.

3.3. Aty ku procedura e rekrutimit parashikon për një afat gjykimi, nevojshëmrisht të shkurtër, pas emërimit në pozitën e gjyqtarit/es por përpara konfirmimit të tij/saj përfundimtar, ose kur rekrutimi bëhet për një afat të kufizuar që mund të rinovohet, vendimi për të mos bërë një emërim përfundimtar ose për të mos rinovuar, mund të merret vetëm nga autoriteti i pavarur i përmendur në paragrafin 1.3 këtu më lart, ose me propozimin e tij, ose me rekomandimin e tij ose me miratimin e tij ose pas mendimit të tij. Dispozitat në pikën 1.4 këtu më lart janë gjithashtu të zbatueshme për një individ të vënë në periudhë prove.

3.4. Një gjyqtar/e që ka ushtron funksionet në një gjykatë nuk mundet, në parim, të emërohet në një pozitë tjetër gjyqësore ose të caktohet diku tjetër, madje as me ngritje në pozitë, pa pasur dhënë lirisht miratimin e tij/saj. Një përjashtim për këtë parim lejohet vetëm në rastin kur transferimi është i parashikuar dhe është shprehur si sanksion disiplinor, dhe në rastin e një ndryshimi ligjor të sistemit të gjykatës, dhe në rastin e një caktimi të përkohshëm për të forcuar një gjykatë fqinjë, me kohëzgjatjen maksimale të këtij caktimi të kufizuar rigorozisht në statut, pa paragjykim për zbatimin e dispozitave në paragrafin 1.4 këtu më lart.

PËRGJEGJËSIA

4.1. Moskryerja nga një gjyqtar/e e njëres prej detyrave të tij/saj shprehimisht të përcaktuara në statut, mundet të shkaktojë vetëm një sanksion me vendim, që rezulton pas propozimit, rekomandimit ose me miratimin e një gjykate ose autoriteti të përbërë nga të paktën gjysma gjyqtarë të zgjedhur, brenda kuadrit të procedurave të një natyre që përmban dëgjimin e plotë të palëve, në të cilat gjyqtari/ja kundër të cilit/ës procedohet duhet të ketë të drejtën e përfaqësimit. Shkalla e sanksioneve që mund të vendosen parashikohet në statut, dhe vendosja e tyre i nënshtrohet parimit të përpjesëtueshmërisë. Vendimi i një autoriteti ekzekutiv ose i një gjykate, ose i një autoriteti që shpall një sanksion, siç parashikohet këtu, është i hapur për ankim në një autoritet më të lartë gjyqësor.

PUSHIMI I FUNKSIONEVE

5.1. Një gjyqtar/e pushon përfundimisht së ushtruari funksionet nëpërmjet dorëheqjes, vërtetimit mjekësor të paaftësisë fizike, arritjes së kufirit të moshës, përfundimit të afatit të caktuar ligjor ose shkarkimit të shpallur në kuadrin e një procedure të tillë siç parashikohet në paragrafin 5.1 këtu më lart.

5.2. Ndodhja e njërit nga shkaqet e parashikuara në paragrafin 7.1 këtu më lart, përveç arritjes së kufirit të moshës ose përfundimi i një funksioni me afat të caktuar, duhet të verifikohet nga autoriteti i përmendur në paragrafin 1.3 këtu më lart.”

22. MEMORANDUMI SHPJEGUES PËR KARTËN EUROPIANE MBI STATUTIN PËR GJYQTARËT

PUSHIMI I FUNKSIONEVE

6.1 Duhet ushtruar vigjilencë për kushtet në të cilat përfundohet punësimi i një gjyqtari/e. Është e rëndësishme të parashtrohet një listë shteruese të motiveve të përfundimit të punësimit. Këto janë kur një gjyqtar/e jep dorëheqjen, vërtetohet mjekësisht se është fizikisht i/e papërshtatshëm/me për funksione të mëtejshme gjyqësore, arrin kufirin e moshës, arrin në fund të një funksioni me afat të caktuar ose shkarkohet në kontekstin e një përgjegjësie disiplinore.

6.2 Me ndodhjen e njëres nga ngjarjet që janë motiv për përfundimin e punësimit përveç atyre – si arritja e kufirit të moshës ose fundi i një funksioni me afat të caktuar. Ky kusht realizohet lehtë kur pushimi i funksioneve rezulton nga një shkarkim i vendosur pikërisht nga ky autoritet ose me propozimin ose rekomandimin e tij, ose me miratimin e tij.

III. VLERËSIMI I KËSHILLIT

23. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi vlerësoi aktet e administruara, kërkesën e z. {...} për kthimin në funksionin e gjyqtarit si edhe dispozitat ligjore që rregullojnë kërkimin e tij, e konsideron atë të pabazuar në prova dhe në ligj me arsyetimin si më poshtë.

24. Së pari: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, para ndryshimeve të saj të vitit 2016, parashikonte në nenin 135 se pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Në nenin 138 parashikohej, gjithashtu, se koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera të tyre nuk mund të ulen. Kushtetuta është ajo që jep garancitë bazë në lidhje me statusin e gjyqtarëve dhe më tej ka qenë ligji i posaçëm, Ligji nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që rregullonte statusin e tyre.

24.1 Sistemi i garancive që gëzojnë gjyqtarët sanksionohet edhe në dokumente ndërkombëtare. Kështu, Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, në paragrafin 1/1, shprehet se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elementë këto që çdo individ

i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Gjithashtu, “*Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit*” (miratuar me Rezolutat 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe 40/146, datë 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së), në paragrafin 11, sanksionojnë se mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme.

24.2 Ligji nr.9877, datë 18.02.2008 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*” garanton në dispozitat e tij të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve, pranimin dhe emërimin e tyre, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile. Në mënyrë shteruese në nenin 20 ky ligj ka përcaktuar rastet e përfundimit të statusit të gjyqtarit e më konkretisht kur gjyqtari: a) jep dorëheqjen; b) mbush moshën 65 vjeç, të daljes në pension; c) dënohet me vendim gjyqësorë të formës së prerë, ç) shkarkohet nga detyra.

24.3 Sistemi i garancive në lidhje me ruajtjen e vendit të punës dhe për rrjedhojë, edhe të statusit, është pasqyruar edhe në rastet kur gjyqtari punonte në detyrën e jogjyqtarit pranë një institucioni të sistemit të drejtësisë, sikurse ka të bëjë edhe çështja në shqyrtim në rastin konkret.

23.4 Konkretisht në nenin 28 të ligjit 9877/2008 përcaktohej se: “1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës. 2. Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave...omissis”. Ndërsa në nenin 4, pika 6, të Ligjit nr.8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, përcaktohej se: “Gjyqtarët dhe prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtar a prokuror pa konkurs”.

24.5 Sa sipër, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ishte organi kushtetues përgjegjës për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve (të shkallës së parë dhe apelit) dhe përgjegjësisë disiplinore të tyre. Për të realizuar këto përgjegjësi, Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhej në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizonin lidhjen me korpusin gjyqësor, duke e mundur në këtë mënyrë pavarësinë e Gjykatës dhe duke e mbrojtur atë nga ndërhyrjet e çdo pushteti tjetër. Në bazë të neneve 18-27 të Ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” (ligji i kohës) përcaktohej se vullneti i këtij organi realizohej nëpërmjet vendimmarrjes kolegjiale të arritur nga shumica e votave të anëtarëve të pranishëm. Një vullnet i tillë është shprehur edhe për dhënien e pëlqimit (Vendimi nr.230, datë

28.05.2008 të Këshillit i Lartë të Drejtësisë) në bazë të së cilit z. {...} i është dhënë leje për të shërbyer në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa pas këtij lejimi, ai është emëruar dhe ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për një periudhë afërsisht 8 muajore.

24.6 Kjo paketë në kuadër të garancisë ruante statusin e gjyqtarit *ex legge* për ato subjekte që, me pëlqimin individual dhe vendim të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjatë gjithë periudhës trevjeçare ushtronin detyra ekzekutive në Ministrinë e Drejtësisë. Gjatë ushtrimit të detyrës në organet e sipërcituara, funksioni i gjyqtarit dhe statusi i gjyqtarit ruhej për periudhën trevjeçare. Vazhdimi i detyrës pas kalimit të këtij afati pa pëlqimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkaktonte humbjen e statusit të gjyqtarit. Megjithatë, me këto parashikime ligjore, kuptohet se edhe nëse gjyqtari që kishte marrë pëlqimin e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë kërkonte të ndërpriste periudhën trevjeçare të komandimit ose shërbimit në një organ tjetër të sistemit të drejtësisë, dhe kërkonte të vijonte punën e tij si gjyqtar, kjo ishte një e drejtë e tij dhe nuk lidhej me ndonjë detyrim, por vetëm me kërkesën drejtuar ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për t'u rikthyer në funksionin e gjyqtarit.

24.7 Edhe në Ligjin aktual nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”, në nenin 57, përcaktohet se: “Magjistrati me një pozicion të përhershëm, kur përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrrojë funksionin, sipas parashikimeve të nenit 59, të këtij ligji, pas mbarimit të periudhës së përkohshme ka të drejtë të kthehet në pozicionin e mëparshëm të përhershëm”.

24.8 Nga materialet e çështjes rezulton se z. {...} më datë 28.05.2008, me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë dhe me pëlqimin e tij, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendim, dhe ka lejuar z. {...} që të shërbejë në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë. Pas kësaj, me Vendim të Këshillit të Ministrave “Për shkarkim dhe emërim në detyrë”, z. {...} është emëruar në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Më tej, gjatë ushtrimit të këtij funksioni, po me vendim të Këshillit të Ministrave (Vendimi 54, datë 21.01.2009, “Për shkarkim dhe emërim në detyrë”), është vendosur që z. {...} të shkarkohej nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zgjidhje kjo e kontratës së shërbimit që ka ndodhur brenda afatit trevjeçar të lejes së akorduar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

24.9 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 566, datë 23.08.2006, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, në pikën 6, parashikonte se: “...Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, ndërsa 2 zëvendës drejtorët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Drejtori i Përgjithshëm dhe 2 zëvendës drejtorët e agjencisë propozohen nga radhët e personave të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe integritet të lartë personal...”.

24.10 Pikërisht mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 566, datë 23.08.2006, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”,

z. {...}, ndërsa kishte statusin e gjyqtarit, është emëruar nga Këshilli i Ministrave në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në vijim të ushtrimit të funksionit të tij, në Shtator 2008, mbi referimin e oficerit të policisë gjyqësore, ndaj z. {...} ka filluar një procedim penal, ndërsa në Tetor 2008, ai është marrë në cilësinë e të pandehurit për veprën penale të “*Shpërdorimit të detyrës kryer në bashkëpunim*”, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të K. Penal. Ndërkohë, pas kësaj, në Janar 2009, me vendim të Këshillit të Ministrave, z. {...} ai është shkarkuar nga detyra Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Vlen të theksohet se fakti penal për të cilin z. {...} është proceduar penalisht ka qenë i ndryshëm nga faktet që kanë përbërë shkelje disiplinore dhe mbi të cilat është marrë masa ekstreme e shkarkimit nga detyra.

24.11 Pas shkarkimit nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pra mbas datës 21.01.2009, z. {...} nuk ka kryer më ndonjë detyrë pranë institucionit të sistemit të drejtësisë (Ministrisë së Drejtësisë), ku ishte lejuar të shërbente për një periudhë trevjeçare me vendim të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Nga ana tjetër, pas shkarkimit nga detyra si më lart, z. {...} nuk ka treguar asnjë interes për t’u rikthyer në detyrën e gjyqtarit, nëse supozonte se vijonte të mbante statusin e gjyqtarit.

24.12 Leja për të shërbyer në një institucion të sistemit të drejtësisë z. {...} i ishte dhënë me kusht që të shërbente në këtë institucion, dhe vetëm në këto kushte ai ligjërisht ruante statusin e gjyqtarit, ndërsa periudha e shërbimit i njëjti si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale. Nisur nga kjo, në rrethanat kur z. {...} ka ndërprerë shërbimin pranë institucionit të sistemit të drejtësisë ku ishte lejuar nga organi kompetent, mbi supozimin se vijonte të ruante statusin e gjyqtarit, ai duhet t’i kishte kërkuar ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë kthimin në funksionin e gjyqtarit, gjë të cilën nuk rezultoi ta ketë bërë as menjëherë pas ndërprerjes së shërbimit dhe as në fund të periudhës trevjeçare të lejes për të shërbyer, por vetëm më datë 18.02.2013, pra pas më shumë se pesë vjetësh nga ndërprerja e shërbimit, mënyrë të vepruari kjo që nënkupton heqjen dorë nga të drejtat e tij.

24.13 Një gjyqtar ka përgjegjësi specifike në fushën e administrimit të drejtësisë, një sferë në të cilën shtetet ushtrojnë pushtet sovran. Për pasojë, një gjyqtar, ndërsa merr pjesë, sipas ligjit, në ushtrimin e pushteteve të tjera, ka të drejtën, por dhe detyrimin, për t’u kthyer në funksionin e vetë pas ndërprerjes apo përfundimit të periudhës së shërbimit në një institucion të sistemit të drejtësisë.

24.14 Në kushtet kur z. {...} nuk ka përfunduar normalisht ushtrimin e detyrës në institucionin e sistemit të drejtësisë ku ishte lejuar, kjo për shkak të shkarkimit të tij nga organi kompetent, në supozimin e ruajtjes së statusit të gjyqtarit, ai duhet të kishte kërkuar ri integrimin në sistemin gjyqësor, pra rikthimin në funksionin e gjyqtarit. Por, z. {...}, me veprime konkludente, përmes mos kërimit të kthimit në detyrën e gjyqtarit, ka shprehur vullnetin për të mos vijuar mbajtjen e statusit të gjyqtarit, duke nënkuptuar dorëheqjen e tij dhe njëkohësisht mbarimin e statusit. Instituti i dorëheqjes së gjyqtarit nuk ka gjetur rregullim të detajuar në Ligjin nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ligji nuk përcakton procedurën dhe institutin e formës, *solemnitas verborum*, të aktit të dorëheqjes. Për rrjedhim, në kushtet kur

nuk kërkohet që forma e aktit të jetë shkresore, vullneti i kërkuesit deduktohet nga qëndrimi subjektiv i tij ndaj detyrimit kushtetues për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në vendin e punës ku ai është emëruar.

25. Së dyti: Faktin e vazhdimësisë së detyrës dhe detyrimin e kthimit në punë për të përmbushur detyrimet që rrjedh nga kontrata e shërbimit, në mënyrë indirekte e pranon edhe z. {...}, kur në objektin e padisë, me anë të së cilës ai ka investuar Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka kërkuar: ***“Detyrimin e palës së paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë të marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur për të rikthyer në detyrën e gjyqtarit, në respekt të statusit të paditësit si edhe detyrimin për të paguar pagën e gjyqtarit nga data 21.02.2009 deri në fillimin e detyrës”***. Kjo datë i korrespondon periudhës një muaj pas shkarkimit, me vendim të Këshillit të Ministrave, nga detyra e Drejtorit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

25.1 Në këto kushte, “punëdhënësi” ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk mund të vijonte ruajtjen e vendit të punës si gjyqtar për z. {...} pasi veprimi konkludent i mos kërkimit të kthimit në detyrën e gjyqtarit pa shkak, është interpretuar si dorëheqje e tij nga ky funksion dhe, rrjedhimisht, si mbarim i statusit të gjyqtarit. Për rrjedhim, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.6265, datë 16.09.2009, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve, për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit”, ndër të tjera, është vendosur: “...omissis...19) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, 19 gjyqtar...”, *reduktimi i numrit të gjyqtarëve nga 21 në 19”*.

26. Së treti: Nga verifikimi i kryer rezulton se Z. {...} nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky është tregues tjetër konkludent i vullnetit të z. {...} për heqjen dorë nga statusi i gjyqtarit. Sipas këtij ligji, të gjithë subjektet që gëzojnë statusin e gjyqtarit, janë përcaktuar si subjekt rivlerësimi kalimtar dhe si të tillë ata kanë pasur detyrimin ligjor për plotësimin dhe dorëzimin e formularëve përkatës të pasurisë, figurës dhe vetëvlerësimit profesional, me qëllim mundësimin e procedurës së rivlerësimit në përputhje me dispozitat ligjore të këtij ligji. Z. {...} nuk e ka përmbushur një detyrim të tillë ligjor, çka të çon në përfundimin se ai ka hequr dorë nga statusi i gjyqtarit, rrjedhimisht nga të drejtat dhe detyrimet që burojnë prej tij.

27. Së katërti: Gjatë gjithë procesit penal të zhvilluar dhe konkluduar me Vendimin nr.718, datë 07.05.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë, z. {...} nuk ka ngritur ndonjë pretendim për cenim të drejtave dhe garancive të dhëna nga ligji mbi shkakun e pasjes ai të statusit të gjyqtarit, për rrjedhojë as kërkesë për pavlefshmëri aktesh të procedimit penal. Referuar nenit 29, pika 1, të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësorë në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit ***“Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë ose gjyqtari i gjykatës së apelit mund të ndiqet penalisht, sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Autorizimi për fillimin e procedimit penal bëhet me miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”***, është e qartë se për të filluar procedim penal ndaj një gjyqtari duhej të jepej autorizimi nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kjo dispozitë është qartazi pjesë e paketës së garancive për individët që gëzojnë statusin e gjyqtarit, ku kërkohet autorizimi i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit penal, gjë që nuk ka ndodhur në rastin në fjalë, fakt tjetër që tregon se z. {...}

nuk ka konsideruar mbajtjen nga ai të statusit të gjyqtarit dhe hequr dorë nga garancitë e dhëna nga ligji.

27.1 Gjithashtu, në këtë pikë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se nuk jemi as para parashikimeve të nenit 29, pikat 3 dhe 4, të Ligjit 9877/2008, që parashikonte se: “3. Në rastin kur ndaj një gjyqtari jepet autorizimi për fillimin e procedimit penal, ai pezullohet nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë. 4. Në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në punën e tij të mëparshme dhe të marrë pagën e plotë që nga koha e pezullimit”. Përsa kohë rezulton që ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka dhënë autorizim për fillimin e procedimit penal ndaj z. {...}, ai nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni i tij, prandaj, pavarësisht se ai me vendim të formës së prerë është deklaruar i pafajshëm, z. {...} nuk kishte më të drejtë të kthehej në detyrën e tij të mëparshme dhe as të merrte pagën e plotë që nga koha e pezullimit. Duke mos kërkuar dhe mbrojtur të drejtat që atij i ishin njohur me Kushtetutë dhe ligj, konkludohet se z. {...}, me veprime të qarta konkludente, ka hequr dorë nga statusi i gjyqtarit dhe garancitë që vijnë prej tij.

27.2 Vlen të theksohet se z. {...}, në vitin 2008, pavarësisht se është Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka gëzuar statusin e nëpunësit civil, pasi nuk rezulton ta ketë fituar atë. Për rrjedhojë, nuk aplikohet as neni 22 i Ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, që parashikonte se: “1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve ligjore për periudhën sa zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe nëpunësi civil rimerr vendin e tij në shërbimin civil, me përjashtim të rastit kur dënohet me heqje lirie. 2. Nëpunësi civil pezullohet: a) kur ndaj tij fillon ndjekja penale për shkak të detyrës ose për krime të rënda, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar...”. Pra, në çdo rast, z. {...} nuk është pezulluar nga puna ose funksioni e për rrjedhojë, afati kohor ka ecur e në vitin 2013 kishte kaluar edhe afati 3 vjeçar i periudhës së lejuar për të shërbyer në një institucion të administratës shtetërore, konkretisht në Ministrinë e Drejtësisë. Për më tepër, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstaton se z. {...} është shkarkuar nga detyra në Janar 2009, ndërkohë që ndjekja penale ka filluar në Shtator 2008, për më tepër për fakte të ndryshme nga ato për të cilën ai është shkarkuar nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

28. Së pesti: Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.54, datë 21.01.2009 “Për shkarkimin dhe emërimin në detyrë”, ndër të tjera, është vendosur “1. Z. {...} Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shkarkohet nga kjo detyrë...omissis..”. Nga aktet shkresore, përfshirë edhe ato të depozituar nga z. {...}, nuk rezulton që ky akt administrativ individual të jetë goditur për pavlefshmëri në gjykatë.

28.1. Akti administrativ individual i mësipërm, si *shfaqje e një vullneti pushteti nga organi që ushtron veprimtari administrative, në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me ligjet, me qëllim krijimin, ndryshimin ose shuarjen e pasojave të caktuara juridike*, vazhdon të jetë në fuqi dhe ky akt ka zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën e shërbimit mes z. {...} dhe autoritetit publik.

Shkarkimi nga detyra i një gjyqtari, i cili, me kërkesën e një institucioni të sistemit të drejtësisë dhe me pëlqimin e tij, me vendim të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është lejuar të shërbejë në atë institucion, përbën shkak për mbarimin e statusit të gjyqtarit në kuptim të nenit 20, germa “ç”, të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “Gjyqtari nuk mund të lëvizë nga detyra, përveç rasteve kur : ...; ç) **shkarkohet nga detyra**”. Kjo për shkak të fuqisë së pa kontestuar dhe efekteve juridike të aktit administrativ të zgjidhjes së kontratës së shërbimit publik. Gjithashtu, z. {...} nuk mund të mbrohet me argumentin se ka pritur përfundimin e çështjes penale për të rivendosur të drejtat e tij, për shkak se shkarkimi i tij nga funksioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato për të cilën ai është proceduar penalisht.

28.2 Referuar ligjit të kohës, Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për gjyqtarin, që me kërkesën e institucioneve e me pëlqimin e tij, si dhe me vendim të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës së shërbimit në *strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, në administratën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, apo si prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës*, nuk parashikonte rregullimin e përgjegjësisë disiplinore. Përpos kësaj, ky ligj nuk ka përjashtuar nga përgjegjësia disiplinore ata gjyqtarë që, me pëlqimin e tyre, lejoheshin të shërbenin, për një periudhë deri në 3 vjet, në një institucion brenda sistemit të drejtësisë. Duke mos i përjashtuar nga përgjegjësia disiplinore, si dhe duke heshtur sa i përket rregullimit të kësaj përgjegjësie, mund të konkludohet se ligji i kohës ka pranuar përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve që, me pëlqimin e tyre, lejoheshin të shërbenin në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, përgjegjësi kjo që rregullohej rast pas rasti sipas ligjit organik të institucionit përkatës, ku gjyqtari lejohej të shërbente, me pëlqimin e tij. Në këtë kuptim, çdo procedurë e vlefshme disiplinore e ndjekur sipas ligjit organik përkatës të atij institucioni, brenda sistemit të drejtësisë, ku gjyqtari është lejuar të shërbejë sipas kërkesave të nenit 28 të Ligjit të lartpërmendur, në të cilën është urdhëruar marrja e masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”, përbën në çdo rast një rrethanë që çon në mbarimin e statusit të gjyqtarit.

28.3 Ligji i kohës i vitit 2008, ndryshe nga ligji aktual (*Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*), nuk parashikonte mundësinë dhe të drejtën e gjyqtarit të lejuar, me pëlqimin e tij, që shërbente në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, të kërkonte shqyrtimin e procedimit disiplinor nga organi qeverisës i këtij sistemi, pra nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Përkundrazi, duke heshtur, ligji i kohës ka konsideruar të vlefshëm çdo masë disiplinore të dhënë nga institucioni përkatës ndaj gjyqtarit të lejuar, me pëlqimin e tij, për të shërbyer në një institucion brenda sistemit të drejtësisë.

28.4 Vlen të theksohet se në ligjin aktual që rregullon statusin e gjyqtarit, pra në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ato çka në mënyrë të heshtur rezultojnë nga ligji i mëparshëm që ka rregulluar statusin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, sa i përket përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit që, me pëlqimin e tij, lejohej të

shërbente në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, janë parashikuar tashmë shprehimisht, pikërisht në nenin 53, pika 12.

29. Së gjashti: Ligji aktual nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se ekzistenca e masës disiplinore “*Largim nga detyra për shkaqe disiplinore*” përbën kriter ndalues për rekrutimin e gjyqtarit (neni 28, shkronja “dh”), përveç se edhe shkak për mbarimin e statusit të magjistratit në rast të verifikimit të mëvonshëm të një rrethane të tillë (neni 64/b dhe neni 66).

29.1 Sa më sipër, përsa kohë Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.54, datë 21.01.2009, “Për shkarkim dhe emërim në detyrë” është ligjërisht në fuqi dhe i pa kontestuar gjyqësisht nga z. {...}, një rrethanë e tillë përbën shkak pengues për rikthimin e tij në detyrën e gjyqtarit, përderisa sipas ligjit kjo rrethanë çon në humbjen e statusit të gjyqtarit. Pavarësisht të kalimit të një afati të konsiderueshëm kohor nga marrja e masës disiplinore “largim nga detyra”, ligji nuk e lidh ekzistencën e kësaj rrethane ligjore me shuarjen ose jo të masës. Gjithsesi, ky argument vlen për të evidentuar se përtej çdo arsytimi, kthimi i z. {...} në funksionin e gjyqtarit tashmë është bërë i pamundur dhe nga ligji aktualisht në fuqi, pra Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61, pika 2, shkronja “a”, 86 dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 57, 64 dhe 167, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Refuzimin e kërkesës së {...}, për kthimin në funksionin e gjyqtarit.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi të arsyetuar.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR